



Vlaanderen
is divers

RREGULLORE E TESTIT PËR PËRJASHTIMIN NGA DETYRIMI (PËR TË NDJEKUR) ORIENTIMIN NË SHOQËRI

1 /9/2023

Për të marrë një vërtetim integrimi, ti duhet t'i arrish qëllimet/synimet për pjesën përbërëse të trajektit Orientim në Shoqëri (MO).

Kjo rregullore përcakton se si ti i arrin qëllimet e MO.

Agentschappen Integratie en Inburgering (Agjencitë e Integritimit) të urojnë sukses në test për përjashtim nga detyrimi (për të ndjekur kursin).

1 CILËT JANË QËLLIMET E PJESËS PËRBËRËSE TË TRAJEKTIT MO?

Qëllimet i gjen në documenten.mijninburgering.be.

Këta qëllime përshkruajnë:

- çfarë duhet të kuptosh në fund të pjesës përbërëse të trajektit
- çfarë duhet të jesh i aftë të bësh në fund të pjesës përbërëse të trajektit
- cilat vlera dhe norma janë të rëndësishme

2 SI I ARRIN TI QËLLIMET PËR MO ME ANË TË NJË TESTI PËR PËRJASHTIM NGA DETYRIMI (PËR TË NDJEKUR KURSIN)?

Ti e kalon testin MO. Testin e bën **në funksion të përjashtimit nga detyrimi (për të ndjekur)** për pjesën përbërëse të trajektit MO.

Në cilën situatë lejohet të bësh testin?

- Ti je paraqitur në një Agentschap Integratie en Inburgering.
dhe
- Ti nuk ke nënshkruar akoma një kontratë integrimi.

Kur e bën një test për përjashtim nga detyrimi? Rreth 30 ditë pas paraqitjes tënde.

2.1 Si vlerësohesh ti gjatë testit për përjashtim nga detyrimi (për të ndjekur) MO?

Rezultati i testit i mundshëm është 'kalon' ose 'nuk kalon'.

Ti ke kaluar në testin për përjashtim nga detyrimi (për të ndjekur) MO nëse ti:

- merr minimumi 80% në të gjithë testin MO DHE
- merr minimumi 80% në pyetjet mbi vlerat dhe normat në Belgjikë.

3 TESTI MO

3.1 Si është i organizuar 'testi pas kursit'?

3.1.1 Takimi

- Të jepet një takim në një qendër testimi.
- Sill me vete një provë identiteti!
- Eja 15 minuta para fillimit të testit në vendin kur është lënë takimi!

3.1.2 Bën test për përjashtim nga detyrimi (për të ndjekur kursin)

- Ti e bën testin me kompjuter.
- Testi përbëhet nga pyetje me disa zgjedhje.
- Të lejohet të punosh për testin për maksimumi 120 minuta.

3.1.3 Vlerësim i test për përjashtim nga detyrimi (për të ndjekur kursin)

Kompjuteri e vlerëson testin automatikisht.

3.2 Cilat janë rregullat gjatë testit?

- Të jepet një ftesë për testin.
- Ti vjen 15 minuta para fillimit të testit në vendin ku është lënë takimi!
- Një punonjës kontrollon identitetin tënd me anë të provës së identitetit tënd. Përdor identitetin e një personi tjetër? Atëherë kjo gjë është e dënueshme (me ligj). Gjykata mund të të ndjekë penalisht.
- Ti e bën testin individualisht (vetë)! Ti nuk flet me pjesëmarrësit e tjerë gjatë testit! Në lokalin e testit lejohen të jenë vetëm pjesëmarrësit.
- Nuk lejohet t'a kopjosh apo t'a fotografosh testin. Nuk lejohet t'i kopjosh pyetjet. Nuk lejohet t'i publikosh pyetjet. Kjo gjë është e dënueshme (me ligj). Gjykata mund të të ndjekë penalisht.
- Ti e fik telefonin tënd celular! Ti e vendos atë në një vend tjetër deri pas testit!
- Ti rri në lokal (klasë) të testit gjatë testit!

- Ti nuk merr asgjë me vete nga klasa e testit!

Nuk i rrespekton këto rregulla?

Punonjësi nuk e fillon testin tënd, apo e ndalon testin tënd. Punonjësi bën një raport të situatës. Ti ke marrë pjesë zyrtarisht në test. **Ti nuk e ke kaluar (testin).**

Ti duhet të ndjekësh kursin MO. Pas kursit MO ti e bën përsëri testin MO.

3.3 Çfarë ndodh nëse nuk merr pjesë në test MO?

3.3.1 Ti nuk mund të vish? Ti vjen me vonesë?

Kontakto menjëherë një punonjës!

Ty të nevojitet (duhet të kesh) një arsye e vlefshme:

Ti je i/e sëmurë.

Është një situatë urgjente (e papritur).

Kontakto udhëzuesin tënd të trajektit për të diskutuar mbi situatën!

Ti merr një takim tjetër për testin!

Vjen me vonesë? Ti nuk mund të marrësh më pjesë në test.

Vini re në këto 2 situata

- Ti nuk e kontakton punonjës-in apo udhëzuesin tënd të trajektit.
- Ti nuk ke një arsye të vlefshme për të ardhur me vonesë apo për të mos ardhur.

Në këto 2 situata ti **nuk e ke kaluar** testin.

Ti duhet të ndjekësh kursin MO. Pas kursit MO ti e bën përsëri testin MO.

3.3.2 E anulon qendra e testimit takimin?

Qendra e testimit mund t'a anulojë një test për arsye të një situatë utgjente (të papritur). Një punonjës të kontakton.

Të jepet një takim tjetër.

4 REZULTATI I TESTIT PËR PËRJASHTIM NGA DETYRIMI (PËR TË NDJEKUR) MO

4.1 Si të jepen rezultatet?

Agjencia e dërgon rezultatin me shkrim, maksimumi 3 javë pas testit.

Rezultatet regjistrohen në dosjen tënde në sistemin e klientëve të Vlaamse Agentschap Integratie en Inburgering, Atlas (Antwerpen) en Integratie en Inburgering Gent.

4.2 Çfarë ndodh nëse ti nuk e kalon testin për përjashtim nga detyrimi (për të ndjekur) MO?

Ti duhet t'a ndjekësh kursin MO. Pas kursit MO bën edhe një herë një test MO.

5 SA KUSHTON TESTI PËR PËRJASHTIM NGA DETYRIMI (PËR TË NDJEKUR) MO?

Çmimin e 'kursit dhe testit MO' e gjen në 'Rregulloren e Faturave Qeveritare për Integrimin'

6 KE NJË HANDIKAP (AFTËSI TË KUFIZUAR), PROBLEM PËR TË MËSUAR APO SËMUNDJE?

Na e komunikojë gjatë regjistrimit handikapin tënd (aftësinë e kufizuar), problemin tënd për të mësuar apo sëmundjen tënde!

Një punonjës e shikon bashkë me ty se cilat përshtatje janë të mundura.

7 KE NDONJË ANKESË APO DO TË BËSH ANKIMIM?

7.1 Nuk je i/e kënaqur me kursin, me testin apo me procedurën?

Ti mund të bësh një akese.

Shko tek faqja e internetit [www.integratie-inburgering.be/klacht-of-beroep!](http://www.integratie-inburgering.be/klacht-of-beroep)

7.2 Nuk je dakord me rezultatin?

Ti mund të bësh ankimim.

Kur?

Maksimumi 30 ditë pasi ti ke marrë rezultatin.

Si?

Shko tek faqja e internetit [www.integratie-inburgering.be/klacht-of-beroep!](http://www.integratie-inburgering.be/klacht-of-beroep)

Ankimimi yt duhet bërë me shkrim.

Një komision i ankimeve e rishikon rezultatin tënd.

Komisioni i ankimeve vendos mbi ankimin tënd maksimumi 60 ditë pasi ai e ka marrë ankimin.